



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 31.1.2025

Nr: 57

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË AGJENCISË
PËR DIALOG DHE BASHKËQEVERISJE, PËR PERIUdhËN 19 JANAR – 25 JANAR
2025

Sot, më datë 31.1.2025 unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBJEKT: Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje për periudhën 19 janar deri më 25 janar 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 19- 25 janar 2025, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon.

Data: 31.1.2025 Nr: 57
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje për periudhën 19 janar – 25 janar 2025”

- Në datën 20.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 24.1.2025, ora 11.00, Njësia Administrative Korçë, me tematikë “Tjetër”, “Aktivitet për Ditën Ndërkombëtare të Edukimit.

Nëpërmjet email-it, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, një informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes, ose t’i paraqesë ato në seancën publike të datës 31.1.2025, ora 12:00.

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje ka dërguar pretendimet, duke sqaruar se: “*aktiviteti u raportua me vonesë për shkaqe të moskonfirmimit në kohë të pjesëmarrësve të aktivitetit. Pasi ka marrë statusin si e “E Ndaluar” nga KQZ-ja, u morën masa për mosrealizimin e tij, pra aktiviteti u anulua.*”.

Për sa më sipër, pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, veprimtaria e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, pasi ka marrë statusin “E Ndaluar” në NRI, nuk është zhvilluar. Në këto kushte nuk jemi para kundërvajtjes administrative, për aq sa ky aktivitet nuk është zhvilluar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI